



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Kuvendit Komunal të Novobërdës
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë dispozitave të nenit 36 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e tetë e K.K-së, e cila do të mbahet më **27.09.2022** (e martë) duke filluar në ora **10:00h**.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;
2. Propozim dhe aprovim Buxheti për vitin 2023/25;
3. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit për thuarjen e marrëveshjes ndërkomunale dhe pruarja e vendimit që Kryetari i Komunës të vazhdoj me procedurat sipas Udhëzuesit për bashkpunim ndërkomunal dhe ndërkombëtar;
4. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit për mbikqyrjen e aktiviteteve të Komunës dhe Kuvendit;
5. Formimi i Komisionit 5 antarësh për mbikqyrjen e procedurave për përcaktimin e shtëpis informative për përcjelljen e aktiviteteve të Komunës dhe Kuvendit;
6. Shqyrtimi i informates kthyesë nga Ministria rreth punës së komisionit për emrimin e rrugëve;
7. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit për thuarjen e memorandumit të mirëkuptimit në mesë të Komunës së Novobërdës dhe shoqatës vullnetare të zjarrfikseve (SHMZ)
8. Me propozim të Komitetit për Komunitete Raportim nga kompania Hidromorava & D.SH.P rreth furnizimit me ujë të pijshëm për ujësjellësit nënë mbykqyrje të kompanisë Hidromorava;
9. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në Sallen e K.K-së, së Novobërdës.

Më: 23.09.2022
Në: Novobërdë

zonj. Mirjana Simijonovic
Kryesuese e Kuvendit





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

ZYRA E KUVENDIT/KANCELARIJA SKUPŠTINE

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e shtatë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 28.07.2022, duke filluar në orën 10:15.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Kuvendit znj.Mirjana Simijonovic, zv.Kryesuesi i Kuvendit zt.Ramush Mehmeti, Nënkryetari i Komunës për Komunitete zt. Bajrush Ymeri, Nënkryetari i Komunës zt.Svetislav Ivanovic, antarët e Kuvendit: Stojan Stanojevic, Dragana Dimic, Violeta Milosevic, Pranvera Kastrati Gashi, Negovan Jovanovic, Milica Jovanovic, Selatin Nuhiu, Dobrivoje Djordjevic, Ivana Ivanovic, Abdyl Gashi, Drejtori i Financave zt.Milos Denic, Drejtori i Administratës zt.Serboljub Djokic, Drejtori i Shendetësisë zt.Goran Simijonovic, Drejtori i Bujqësisë zt.Sillobodan Savic, zyrtarë komunal dhe qytetarë.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Kuvendit e cila pasi pershendeti të gjithë të pranishmi tha: konstatoj korumin prezent janë 12 anëtarë nga 15 anëtarë gjithësej të Kuvendit, kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojm mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Raporti i Drejtorisë së Arsimit për përfundimin e vitit shkollor 2021/2022;
3. Raporti financiar për tremujorin e dytë prill – qershor 2022;
4. Aprovimi i raportit të punës për gjashtmuajorin e parë të ZKKK;
5. Me propozim të Drejtorisë së Financave, shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për transferin e mjeteve sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2022 nga rezerva e kategorisë ekonomike tek investimet kapitale;
6. Shqyrtimi i propozim vendimit të Kryetarit të Komunës zt.Sasa Milosevic për formimin e KKSB-së;
7. Të ndryshme;

Kryesuesja i pyeti të pranishmit se a pajtohen me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?

Stojan Stanojevic pasi pershendeti të pranishmit tha: i kemi shtatë pika ndërsa vetem për një pikë kemi material, ne mundë të votojm por për pikat e tjera nuk kemi asnjë material.

Kryesuesja tha: edhe në KPF i kemi pasur këto diskutime pasi që edhe në KPF nuk kemi pasur material, sa i perket Drejtorisë së Financave i kemi materialin për të dy pikat, nese pajtoheni do të votojm për këtë rend dite dhe për mbledhjet e ardhshme do ta kemi parasysh që mos të fusim pika pa material, ne e kemi rregulloren e punës së Kuvendit si dhe planin e punës ku punojm në bazë të tyre.

Pasi nuk pati diskutime tjera nga 12 antarë prezent, me 10 vota për dhe 2 apstenime aprovohet rendi i ditës.

Pika e parë: Aprovimi i procesverballit nga mbledhja e kaluar e K.K;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ivana Ivanovic pasi pershendeti të pranishmit tha: sa i perket materialit nga mbledhja e kaluar ka qenë gjithçka në rregull vetem se materialin e kemi marrë vetem në formë online dhe po është e pamundur që të lexohet dhe ju lus nese mundeni në të ardhmen ta dergoni formë fizike pasi që ka qenë e pamundur që të shohim se çka na keni derguar, ju faleminderit.

Kryesuesja tha: kemi pasur probleme në pregaditjen e materialit, tash e kemi një kopje të re dhe besoj që të ardhmen do tju dergojm me kohë edhe kopje fizike.

Selatin Nuhiu tha: sa i perket procesverballit në rregull është nuk kemi vërejtje por në mbledhjen e kaluar keni premtuar se do të transmetohen edhe online mbledhjet, unë kam provuar ti shikoj por nuk kanë qenë të transmetuara, nuk e di a ka qenë problemi vetem të unë apo edhe te dikush tjetër.

Kryesuesja tha: e di se çdo mbledhje ingjizohet dhe nese ka pasur ndonjë gabim teknik që nuk është transmetuar do të bisedojm me zyrtarin pergjegjës.

Pasi nuk pati diskutime tjera me 10 vota për, 2 apstenime aprovohet procesverballi nga mbledhja e kaluar e Kuvendit.

Pika e dytë: Raporti i Drejtorisë së Arsimit për përfundimin e vitit shkollor 2021/2022;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë pasi që nuk ishte askush që ta prezantoj këtë pikë.

Stojan Stanojevic tha: këtë pikë ne e kemi kërkuar që të kyçet për Kuvend, ne jemi organ ligjvënës dhe nuk jemi kompetent që ta obligojm Drejtorin që të vij në mbledhje të Kuvendit por nuk e di se si një Drejtorë ose anëtarë i Kuvendit mundë ti injoroj qytetarët, anëtarët e Kuvendit por përsëri kërkoj dhe insisto që Drejtori të jetë prezent.

Selatin Nuhiu tha: shumë interesont kjo pika e Drejtorisë së arsimit pasi që në mbledhjen e komitetit për komunitete ka qenë prezent për këtë pikë dhe ne kemi kërkuar që për mbledhje të Kuvendit të vij Drejtori, ndërsa të mos vij të raportoj Drejtori kjo është shumë injorantë në raport me ne. Këtu ne po i shohim vetem dy Drejtorë që janë sot prezent në seanc, ndërsa tjetër Drejtorë fare nuk vin në mbledhje që të na respektojnë ne si anëtarë të Kuvendit. Besoj se Kryetari i Komunës duhet ta shikoj këtë gjendje dhe të merr masa ndaj atyre Drejtorave.

Abdyl Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: perderisa nuk është prezent Drejtori i arsimit kjo pikë duhet të shtyhet për një nga mbledhjet e ardhshme. Ne deshirojm që ta shohim pasqyren e fillimit dhe mbarimit të vitit shkollor kalendarik.

Kryesuesja tha: ne i kemi marrë shenimet për të gjitha pyetjet që i keni pasur rreth kësaj pike të rendit të ditës, ne si zyre do tja dergojm këto pyetje Drejtorisë së Arsimit dhe besoj se në një nga mbledhjet e ardhshme do ti pergjigjen fteses dhe do të marrin pjesë.

Pika e tretë: Raporti financiar për tremujorin e dytë prill – qershor 2022;

Kryesuesja për këtë pikë ja dha fjalën Zyrtarit Kryesor Financar Zoran Cvetkovic.

Zoran Cvetkovic pasi pershendeti të pranishmit tha: materialin e keni marrë me kohë, e kemi pregaditur raportin tremujor financiar në mënyrë sa më të qartë, të dhënat janë paraqitur me tabela. Në faqen e tretë të këtij raporti janë të hyrat për këtë periudh kohore prill, maj dhe qershor ku totali është 185.077.12€ dhe mundë të them se është një rezultat mjaft i mirë i të hyrave, po e cek edhe njëherë se ky raport është deri në fund të muajit Qershor. Ne si Drejtori e Financave insistojm që çdo obligim mbi 300€ të paguhen. Sa i perket shpenzimeve në faqen tjetër mjetet që kanë qenë të planifikuar për shpenzim janë shpenzuar, për paga dhe meditje janë shpenzuar 529.055,71€, për malrra dhe sherbime 66,621.79€, për subvencione 450€, për investime kapitale 21,292.21€. Kaq sa i perket prezantimit nga raporti financiar nese keni ndonjë pyetje urdhëroni, ju faleminderit.

Stojan Stanojevic tha: sa i perket këtij raporti është një qështje pasi që para disa ditëve kam biseduar me disa puntorë në gjykat dhe çdo ditë Komuna e Novobërdës i merr ka 10 vendime pasi që puntorët fitojn

me padi a është kjo e vertet?, a kemi padi kunder Komunës dhe kush po i fiton ato? Këto qështje dëshiroj që ti kemi të qarta.

Kryesuesja tha: është obligimi yni që të parashtrojm pyetje se pse po ndodhin këto dhe nga kush?.

Zoran Cvetkovic tha: kemi numer të madhë të padive por nuk është faji i qeverisjes së kaluar apo i ndonjë zyrtari pasi që në vitin 2017 është nënshkruar nga Kryeministri pasi votimit në Kuvend se puntorët e arsimit kanë të drejta në shujt pra ushqim ndërsa mjete shtesë nuk na ka lëshuar Qeveria, edhe ne si Komunë e kemi paditur Komunës jo si Komunë por Qeverin pasi që i ka miratuar këto ligje por nuk i ka lëshura mjetet me kohë. Dhe edhe nese fitojn këto mjete i mbulon qeveria e jo Komuna.

Ramush Mehmeti pasi pershendeti të pranishmit tha: sa i perket raportit financiar po e shoh një ndryshim dhe është mirë që ky raport është dorzuar me kohë, por kerkoj të di se shpenzimet e kontraktuara tjera për çfarë janë bërë pasi që asnjë shpenzim nuk gucon të mos jetë i qartë se për çka është shpenzuar.

Selatin Nuhui tha: mendoj se është një raport i mirë pasi po e shoh se të hyrat vetanake në këtë tremujorsh janë rrit dhe kjo është një punë e mirë, te taksat për ndrrimin e destinacionit të tokës më vjen mirë që kjo shumë është rrit dhe po vërehet që është bërë një punë e mirë nga ju pasi që i keni detyruar që të pagueni, por në anen tjetër të lejet ndertimore mendoj se kjo shumë është pak mendoj se duhet të jetë një shumë më e madhe, kerkoj që të jenë më aktiv inspektoret Komunal dhe ti obligojnë qytetarët që ndërtojnë për leje ndertimore.

Abdyl Gashi tha: një qështje që dëshiroj ta ngris është vendosja rreth rrugëve e bilibordave që po vendosen anekend Komunës, kerkoj të di se a janë të përfshir në tatim dhe a është bërë ndonjë plan prej Drejtorisë së Financave që moë të lejojn vendosjen e këtyre dhe të krijojnë të hyra për Komunë.

Pasi nuk pati diskutime tjera nga 12 antarë prezent 12 votuan për Aprovimin e raportit Tremujorë Financiar dhe u mirrë ky:

VENDIM

APROVOHET raporti financiar i Komunës së Novobërdës për tremujorin e dytë financiar Prill - Qershor të vitit 2022.

Zoran Cvetkovic tha: sa i perket bilibordeve kemi munges të kapaciteteve në Drejtori të Inspeksionit po planifikojna që ti rrisim këto kapacitete, gjithashtu edhe pyttes tjetër për leje ndertimi është pasi nuk ka inspektor ndertimi ndërsa sa i perket të hyrave deri në fund të vitit besoj se do të rritet ende.

Pika e katërt: Aprovimi i raportit të punës për gjashtmujojin e parë të ZKKK;

Për këtë pikë Kryesuesja ja dha fjalën Goran Simijonovic.

Goran Simijonovic pasi pershendeti të pranishmit tha: ju kerkoj falje që materialin nuk kemi pasur mundësi që ta dergojm me kohë, gjatë kësaj periudhe kohore kemi punuar në projektin e kthimit dhe të kthimit të qëndrueshëm si dhe në projektin EU-PRK-V, ka filluar ndërtimi i 3 rikonstrukcioneve për projektin rrkv. Punimet pritet të përfundojnë në muajin e ardhshëm. Pas përfundimit të punimeve, familjet do të marrin mobilje, ushqime, sende të bardha dhe një projekt për të gjeneruar të ardhura. Gjithashtu, në bashkëpunim me përfaqësuesit e IOM-it, bëmë një listë të familjeve me fëmijë nën 2 vjeç, në mënyrë që përfaqësuesit e Bazës Bonstill t'u shpërndanin ushqimin dhe higjienën. Afati i fundit për përfundimin e projektit është data 31 gusht. Me ndihmën e zyrës sonë, Osbe organizoi një projekt të quajtur fuqizimi ekonomik i grave në Novobërdë, në të cilin morën pjesë 25 gra nga të tre komunitetet që jetojnë në këtë zonë, disa prej të cilave ishin edhe të kthyer. Osbe siguroi gjithashtu një vizitë në një subjekt biznesi (Dr. Chef) në fshatin Stanisor, ku patën mundësinë të mësojnë për punën, angazhimin dhe sukseset e kësaj kompanie, të gjitha me synimin për të ndihmuar gratë të gjejnë punë apo ide për vetëpunësimi.

ZKKK takohet shpesh me përfaqësues të UNHCR-së dhe AT-së në lidhje me procesin e kthimit spontan në territorin e Bashkisë, organizimin e planit të vizitave dhe aktiviteteve të mëtejshme. ZKKK ka pasur një takim me AT-në lidhur me projektin që do të financohet nga UNMIK-u dhe ku zbatuesi do të jetë AT me

mbështetjen e OKPZ-së. Projekti është në fazën përgatitore, por sipas përfaqësuesve të AT-së, së shpejti do të jetë gati për zbatim. Numri i projekteve të planifikuara për një vit në komunën tonë do të jetë katër. ZKKK ka pranuar 6 kërkesa për kthim në periudhën e kaluar. Procedura e mbledhjes së dokumentacionit është duke u zhvilluar, pra të gjithë ata që kanë aplikuar duhet të plotësojnë dokumentacionin për t'u përfshirë në bazën e të dhënave të OKPZ. Pas kësaj shkojmë në terren me UNHCR-në për të vizituar familjet në terren. Dhe nëse plotësojnë kushtet do të regjistrohen. Pas kësaj mbledhet Komisioni Komunal për Kthim, të cilit do t'i paraqiten rastet dhe do të parapërzgjidhen përfituesit e ndihmës, përkatësisht lloji i ndihmës për të cilin kanë aplikuar.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Dobriwoje Djordevic tha: unë kam disa pyetje, pyetja e parë se cili është funksioni juaj përfaqësues?

Goran Simijonovic tha: jamë ushtrues detyre në Zyren e Kthimit.

Dobriwoje Djordjevic tha: ju është duhur të vini edhe në mbledhje të komitetit për komunitete për të raportuar, gjithashtu keni thënë se nuk e keni marrë ftesën për mbledhje të komitetit, ndërsa më von u vertetua se ftesa ju është dërguar, sa i perket pjesës tjetër sju kam degjuar as se çka keni folur.

Kryesuesja tha: sa i perket komitetit për komunitete edhe në mbledhje të KPF-së kemi diskutuar se nga ky komitet nuk ka ardhur asnjë pikë, aty vetëm po diskutohet por spo ka asgjë konkrete, kam marrë shumë vërejtje se pse nuk po vjen asnjë pikë nga komiteti në Kuvend, dhe siç po shihet ai komitet nuk po funksionon ashtu siç duhet.

Dobriwoje Djordjevic tha: nuk është e vërtetë që komiteti për komunitete nuk po funksionon, unë kam kërkuar që për mbledhje të Kuvendit të jetë prezent Drejtori i arsimit dhe kemi kërkuar nga zyrtari i arsimit të mos vij por të vij Drejtori, në atë komitet kemi diskutime kemi ngritur shqetësimet e qytetarëve si për qenët endacak dhe zyrtari i kthimit na ka premtuar se janë duke punuar në një projekt lidhur me atë drejtim por ende nuk ka asgjë konkrete.

Kryesuesja tha: unë i shoh propozimet dhe diskutimet e juaja në procesverbale por asnjë pikë nuk ka ardhur nga komiteti në Kuvend, në mbledhje të KPF-së votohet për pika të Kuvendit, nuk e kemi marrë asnjë pikë për Kuvend nga komiteti.

Selatin Nuhui tha: po pajtohem plotësisht me kolegun se komiteti për komunitete është shumë aktiv, dhe po ta kujtoj Kryesuesja se në mbledhjen e kaluar ka ardhur një pikë nga komiteti për komunitet të cilën e kam propozuar unë personalisht, ka qenë pika e raportimit nga Drejtori i shëndetësisë për gjendjen e QKMF-së në Komunën e Novobërdës, dhe kjo pikë ka ardhur direkt nga komiteti për komunitete. Ndërsa sa i perket pikave tjera në komunën tonë nuk e din se çfarë pika caktohen për rend dite, ka qenë pika e raportimit për gjendjen e ambientit në Komunë, ndërsa kompanin e vetme për ambient e kemi EkoHigjena dhe kjo kompani është kompani publike për mbeturina, kjo pika pat qenë në Kuvend ndërsa pas 2 javë ishte edhe në komitet dhe unë aty kërkoja që të diskutohet për gjendjen e mjedisit hapsinor të vjen drejtori përkatës dhe të diskutoj për këtë çështje ndërsa drejtorat nuk kanë qenë fare prezent. E kam një pyetje për pikën në fjalë pasi u përmend se ndajnë pako ushqimore deri në moshën 2 vjeçare ndërsa ne si antarë të Kuvendit nuk kemi parë ndonjë njoftim ose shpallje se kush ka të drejtë të aplikoj për këto pako ushqimore, ku janë lajmërimet?.

Kryesuesja tha: nuk po them se komiteti për komunitet nuk po punon, po diskutoni por pikat nuk po vijnë në Kuvend, unë po i përcjelli procedurën diskutohet por propozime nuk po marrim në Kuvend.

Bajrush Ymeri pasi pershendeti të pranishmit tha: kur jemi të kjo pika e komitetit për komunitet ne aty duhet të kemi parasysh që komiteti për komunitet është komitet obligativ, është komitet i formuar nga Kuvendi Komunal, është komitet mbrojtës i të drejtave të komuniteteve e në veqanti të komuniteteve pakic. Përgjegjës për rend të ditës, për kordinim të punëve të komitetit për komunitete janë Nënkrjetari për komunitete, zv.kryesuesi për komunitete, shefja e ZKKK dhe Kryesuesja e komitetit për komunitet. Unë ju them se znj.Shqipe Mustafa është e përgjegjshme shumë, e zonja shumë, dinë ta udhëheq komitetin e komuniteteve shumë mirë dhe mbledhjet i mban me rregull dhe unë mendoj se ajo ka shprehur që diskutimet që janë bërë në komitetin për komunitete dhe pikat që janë kërkuar nga anëtarët e komitetit për

komunitete me automatizem do të shkojnë si pika për rend dite të Kuvendit, përndryshe nuk ka pas asnjë problem që ajo me shkrim të drejtohet zyres së Kuvendit apo Kryesueses së Kuvendit që për mbledhjen e radhës të fus ato pika për rend dite dhe të dalin si kërkesa nga komiteti për komunitete, nuk ka problem asgjë në këtë drejtim por vetëm ka qenë të qështja e mosmarrëveshjeve, tash e tutje do të kërkoj nga Kryesuesja e komitetit për komunitet që ato pika të cilat diskutohen dhe kërkohen të hyjnë në Kuvend ajo me shkrim t'ja dorëzoj Kryesueses së Kuvendit, gjithashtu kërkoj që ato pika kur të diskutohen dhe të vinë në Kuvend, këtu të diskutohen dhe të mirret vendimi i merituar, ju faleminderit.

Kryesuesja tha: ju kuptoj juve por ju mundë të diskutoni pesë orë por nese nuk votohet ajo pikë si të vij në Kuvend.

Goran Simijonovic tha: vetëm një herë nuk kemi marrë pjesë në komitetin për komunitete për arsye teknike, informatat nuk po i keni pasi që vet u deklaruat se nuk po i degjoni diskutimit, sa i perket listës së fëmijëve nënë 2 vjet, lista është në përpunim e siper dhe nuk ka ndonjë plan konkret ose aktivitet të madhë dhe realizohet përmes ZKKK.

Kryesuesja tha: kërkoj nga Drejtori që ti respektoj anëtarët e Kuvendit.

Dobrivoje Djordjevic tha: unë thash se ju keni thënë nuk e keni marrë ftesën e pastj u vertetua se e keni pranuar dhe kjo është keqpërdorim, ju duhet të na informoni neve në çdo mbledhje të komitetit për komunitete.

Kryesuesja tha: e di se materialet ju dergohen të gjithëve nga zyrja e Kuvendit.

Pasi nuk pati tjera diskutime me 10 vota për, 1 apstenim dhe 1 anëtarë nuk është prezent aprovohet Raporti i Zyres Komunale për kthim dhe komunitete.

Kryesuesja propozoi pauzë 5min.

Pas pauzes 5 min vazhdoi mbledhja me pikën e pestë.

Pika e pestë: Me propozim të Drejtorisë së Financave, shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për transferin e mjeteve sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2022 nga rezerva e kategorisë ekonomike tek investimet kapitale; Edhe për këtë pikë Kryesuesja ja dha fjalën Zyrëtarit Kryesor Financiar Zoran Cvetkovic.

Zoran Cvetkovic tha: një nga projektet vitin e kaluar është anuluar, tani në bazë të Rregullores duhet të kyçet dhe këto mjete duhet të barten pasi që nuk kemi mjete të mjaftueshme, këto mjete janë për mirëmbajtje të ndriqimit publik në rrugët lokale. Sa i perket projekteve dhe buxhetit të vitit të kaluar ne nuk mundë të bëjmë asgjë andaj këto mjete kthehen si rezerva gjithashtu në bazë të ligjit lejohet bartja e këtyre mjeteve.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime aprovohet njëzëri kjo pikë nga të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe mirret ky:

VENDIM

APROVOHET vendimi për bartje të mjeteve në vlerë prej 13,000€ nga fondi rezerv i K.K. Novobërdë në kodin buxhetor për investime kapitale për projektin Ndriqimi publik në rrugët lokale.

Pika e gjashtë: Shqyrtimi i propozim vendimit të Kryetarit të Komunës zt.Sasa Milosevic për formimin e KKSB-së;

Kryesuesja tha: ne i kemi komitetet obligative si komiteti për komunitete, KPF-ja por mundë të formojmë edhe komitete tjera siç është KKSB-ja të cilat do të na ndihmojnë më shumë si në punën në Kuvend ashtu edhe Komunës. Për përbërjen e KKSB e kemi udhëzimin administrativ, të gjitha ju e keni marrë propozim vendimin për themelimin e KKSB-së. Unë para vetes e kam udhëzimin administrativ dhe në bazë të udhëzimit administrativ anëtarë të KKSB-së duhet të jenë: Kryetari i Komunës, Komandanti i stacionit të policisë, një përfaqësues i secilës bashkësi fetare, një përfaqësues i secilit komunitet etnik, kryesuesi/ja e komitetit për komunitete, zyrtari për barazi gjinore, drejtori i arsimit, kryetari i këshillit të prindërve të arsimit, një përfaqësues i FSK, një përfaqësues i këshillit lokal për siguri në bashkësi, kryesuesi i ekipit

veprues për siguri në bashkësi, një përfaqësues nga sektori i emergjencave civile komunale, një përfaqësues i OJQ-së, përfaqësuesi i zyres komunale për kthim dhe komunitete, një përfaqësues i mediave lokale, një përfaqësues i komunitetit të biznesit, një përfaqësues i komunitetit të personave më aftësi të kufizuara, i kemi propozimet gjithësej 24 përfaqësues, përfaqësues i komunitetit shqiptarë propozohet që të jetë Avdullah Gashi.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Selatin Nuhiu tha: Kryesuese ne këtu e kemi marrë një rend dite ku po shkrun shqyrtimi i propozimit të kryetarit për formimin e KKSB-së, ne a vetem kemi me shqyrtu këtë listë apo kemi me votu me këta emra prezent, unë kam vërejtje në këtë listë pasi që të përfaqësuesit e komuniteteve serb, shqiptarë dhe romë, kerkoj të dij se në çfarë forme janë zgjedh këta përfaqësues dhe kush e ka zgjedh përfaqësuesen e komunitetit shqiptarë?, përmes kuj janë zgjedhë këta përfaqësues?, këtu është Shqipe Mustafa e kjo nuk ka të drejt të jetë në KKSB pasi që është kryesuese e komitetit për komunitete dhe kjo është një shkelje që po bëhet si dhe përfaqësuesit e komuniteti serb dhe rom nuk janë në bazë të rregullores. Sa i perket komuniteti shqiptarë duhet të mblidhemi ne të gjithë dhe ta caktojm një person, u propozua Avdullah Gashi por si e propozon atë a ka biseduar me dikë?, kerkoj që kjo pikë të shtyhet dhe të kordinohemi në mënyrë që ta kemi një përfaqësues të komunitetit shqiptarë.

Kryesuesja tha: unë e kam udhëzimin dhe sipas udhëzimit kryesuesja shkon automatikisht në KKSB, ndërsa sa i perket përfaqësuesit shqiptarë unë kam besuar se ju keni bërë marrëveshje mesveti, ne mundë të bëjm një pauz në mënyrë që të bisedoni.

Ramush Mehmeti tha: në e murrem një propozim dhe shikuam se kish nevoj për disa permirësime që janë shumë normale, Shqipe Mustafa shkon me automatizëm pasi që është kryesuese e komitetit për komunitete dhe kështu thot udhëzimi administrativ, ndërsa unë si LDK që e kemi shumicen e votave të qytetarëve e kam propozuar përfaqësuesin e shqiptarëve, duhet ta kuptoni se Kuvendi vetem e voton listen ndërsa Kryetari e propozon.

Abdyl Gashi tha: besoj se është e duhur që ka ardhur të formohet KKSB-ja, por këtu po shohim shumë emra dhe nuk e di se cila rregullore e përshkruan që të jenë 24 përfaqësues, unë nuk e di bashkshortën e ka në Kuvend ku e ka mundësin që me ngrit zerin për te drejtata e komunitetit, ndërsa tani e propozojnë edhe bashkëshortin në KKSB kjo është e padrejt dhe e palogjikshme, ju lusim që të jeni pak me serioz.

Kryesuesja tha: para veti e kam udhëzimin administrativ për formimin e KKSB-së, sa i perket komunitetit shqiptarë ju duhet bëni një marrëveshje.

Selatin Nuhiu tha: kryesuese kerkoj nga ti ta perdoresh autoritetin tëndë, Ramush ka propozuar pa biseduar me askënd nese ky ka vota më së shumti edhe ne jemi anëtarë të Kuvendit.

Kryesuesja tha: po propozoj pauz deri sa të bëni një marrëveshje.

Bajrush Ymeri tha: kryesuese është e drejt e jotja me kërkua pauz dhe nuk po ta mohon askush por e para përfaqësuesit e komuniteteve shqiptarë, serb dhe romë cila është mënyra e zgjedhjes së tyre nese don legjimitet me pas ai përfaqësues, p.sh përfaqësuesin e komunitetit serb e ka propozuar Kryetari i Komunës dhe çka ka të keqe, prej komuniteti rom është Edisoni, prej komunitetit shqiptarë e tha shumë mirë Ramush që ne si subjekt politik që përfaqësojmë shumicen e kemi propozuar Avdullah Gashin dhe është shumë normale mos me pas pajtueshmeri të plotë në mes të anëtarëve të Kuvendit për ndonjë emer të veçant.

Selatin Nuhiu tha: unë nuk pajtohem me nënkryetarin pasi që fare nuk janë konsultuar me ne dhe tash për momentin jemi nga 2 përfaqësues të komunitetit shqiptarë, andaj kerkoj që të shtyhet për seancën tjetër pasi që është shtyer që 7-8 muaj të shtyhet edhe një muaj, pasi që nuk është transparente pasi që në list fare nuk figuron Avdullah Gashi.

Ramush Mehmeti tha: edhe njëherë ta sqaroj, këtë list e propozon Kryetari i Komunës, Kuvendi vetem e aprovon dhe nuk ka nevoj me u konsultu me askend.

Procesverbali i Kuvendit

Abdyl Gashi tha: këtu e fajtësoj Kryetarin që nuk është prezent, nënkryetari është i emruar për mi mbrojt të drejtat e komuniteti pakic, kërkoj që kjo pikë të shtyhet pasi që emri i propozuar është edhe kryetar i një subjekti politik.

Kryesuesja tha: propozim vendimin e kemi marrë pa emrin e përfaqësuesit tuaj pasi që ju është lënë juve që ta propozoni por pasi që kemi paknaqësi propozoi një pauzë 5 min që ti shikojmë edhe mundësitë ligjore.

Pas pauzes 5 minuteshe mbledhja vazhdoi.

Kryesuesja tha: pas konsultimeve që patëm propozoi që kjo mbledhje të shtyhet për arsye se kemi mospajtime, andaj kjo pikë shtyhet për ndonjë nga mbledhjet e ardhshme.

Dobrivoje Djordjevic tha: mos ti bie që vetëm pala shqiptare ka mosmarrëveshje pasi që edhe të ne kemi mospajtime, gjithashtu sa i përket Drejtorit të Arsimit ai as në mbledhje nuk merr pjesë asnjëherë e si të jetë pjesë e KKS-së.

Kryesuesja tha: pasi që propozimi ka ardhur nga Kryetari uluni dhe bisedoni me Kryetarin, edhe materialin e kemi marrë me vonesë unë propozoj që të votojmë për shtyren e kësaj pike.

Milica Jovanovic pasi pershendeti të pranishmit tha: kur po flasim për gabimet teknike po shoh se këtu ka shumë gabime dhe duhet ti kushtojmë më shumë kujdes.

Kryesuesja tha: për të gjitha këto vërejtje do të marrim shënime dhe do ti drejtojmë të zyrës përkatëse.

Selatin Nuhiu tha: kryesuese po më vjen mirë që po e tregon autoritetin tëndë dhe po e sheh se është e padrejtë zgjedhja që është bërë.

Pasi nuk pati tjerë diskutime nga 10 anëtarë prezent me 9 vota për dhe 1 nuk ka votuar kjo pikë shtyhet për një nga mbledhjet e ardhshme.

Pika e shtatë: Të ndryshme;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pranvera Kastrati Gashi tha: e sygjerohet dhe i dhë vërejtje kolegut Abdyl Gashi që të jetë hera e parë që me cek si bashkëshorte e Avdullah Gashit, pasi që unë këtu jam deputete e kuvendit komunal e zgjedhur nga ana e qytetarëve.

Kryesuesja tha: mos të keqkuptohemi unë sa e kuptova vetëm u cek se a e lejon ligji ashtu, ne duhet të punojmë të gjithë bashkarisht të kemi materialin 7 ditë përpara, ne smundë të hymë në Kuvend e pastaj ta marrim materialin.

Pranvera Kastrati Gashi tha: është normale të shtyhet apo jo kjo pikë, por mos të ceket se unë jam bashkëshorte e Avdullah Gashit pasi që unë jamë anëtare e Kuvendit.

Abdyl Gashi tha: e kam një shqetësim të madhë pasi që një donator në bashkëpunim me qeverinë e Kosovës do të investojë mbi 200,000,000€ në energjinë e ripertriturshme, dikush ka dalë ka diskutuar me ta dhe besoj se shumë shpejt do të mbledhi faktet me emra se kush i ka kërkuar benificion para se të investojë është mirë që mos të pengohet por të lehtësohet pasi që e gjithë Kosova ka nevojë për energji dhe ka krizë të energjisë për momentin dhe pse të mos krijohet kushte, unë jam i gatshëm me bashkëpunu me secilin zyrtarë në mënyrë që ti krijojmë mundësi që ato mjete të mos shkojnë dikund tjetër, por të vinë në Komunën tonë.

Kryesuesja tha: kemi bërë më shumë të qytetarët si dhe një grup i të rinjve vinë në orët e vona pas mesnates bëjnë zhurmë i kemi njoftuar edhe policinë e dimë se policia e Novobërdës ka pak automobila dhe e ka të vështirë ta mbulojë gjithë territorin e Komunës. Qështja tjetër është se ne e kemi vazhduar memorandumën me Hidromoraven por perseri nuk po kemi ujë në fshatin Koretishtë, kam biseduar me Hidromoraven dhe kanë thënë se janë kyçur një lagje e re.

Milica Jovanovic tha: lus Drejtorët që të rrinë deri në fund të mbledhjeve, në fshatin Prekoc dhe Izvor janë të dëmtuara dy shatka si dhe nese kishin pasur mundësi të vendosin polic të shtrirë në fshatin Prekoc dhe Bostan.

Stojan Stanojevic tha: kam pasur një takim në fshatin Zebinc me qytetarët dhe kanë problem me prerjen ilegale të pyjeve.

Procesverbali i Kuvendit

Ramush Mehmeti tha: unë po i ngris disa shqetësime, kerkoj që në sall të vendosin dy ftohëse (klime) që veres të përdoren për ftohje dhe dimrit për ngrohje, gjithashtu gjendja me ujë edhe në objektin e Komunës nuk ka ujë.

Dobrivoje Djordjevic tha: unë kam kërkuar që marrëveshja me Hidromoraven të mos votohet.

Kryesuesja tha: mendoj se ne si Kuvend me një buxhet mundë ti sigurojm këto klime.

Bajrush Ymeri tha: unë po e ndjej obligim që t'ju informoj lidhur me pyetjen që parashtaroj Abdyli rreth kësaj Kompanie nese e kemi fjalën për të njëjtën, ata janë interesuar fillimisht për marrjen në shfrytëzim të kësaj pjese që janë vendos në Mendollak, unë ju kam thënë se aty e ka kontraten me një firmë tjetër pasi që e ka pa se ka kontraten me dikend tjetër e ka bërë kërkesen për pjesën tjetër të tokës dhe nuk ka asnjë penges vetem se problemi është se ai nuk po percaktohet për hapsiren se ku po deshiron ti vendos, duhet të precizohet së pari se ku deshiron që të investoj, ne duhet të bisedojm mes veti se a na pengojn pasi që aty ka banorë dhe a mujm ne me jetu aty, prandaj kemi mbet me u konsultu ne si banorë që jemi aty se a ka me na paraqit ndonjë problem ne aty që jemi duke jetuar është një pikëpyetje e madhë pasi që krijojnë shumë zhurmë se natyrishtë që jemi për investime por duhet të konsultohemi së pari se a na paraqet ndonjë problem. Në takimin e parë që do ta kem do të kerkoj të dij emrin se kush është ai që po kerkon favore, ne publikisht duhet ta diem se kush është ai që po pengon, kanë dal edhe disa fjalë se ai kinse po don me marrë në shfrytëzim atë pjesë e me ja dhënë dikujt tjetër, por po them përseri se nuk ka asnjë penges dhe se pengesa e vetme është pelqimi i komunitetit që jetojnë aty.


Abdyl Gashi tha: sa pengon sa nuk pengon është fushë e ekspertizave dhe ju nënkryetar nuk e di se çfarë lamië keni të kryer që po drejtohesh si ekspert pasi që ne ju deshirojm mirëseardhje këtij investimi me këtë shumë kaq të madhe dhe une ju lus që t'ja hapni rrugët këtij investimi.

Pasi nuk pati diskutime tjera Kryesuesja i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:35.

Valmire Mustafa

Procesmbajtëse



Mirjana Simijonovic
Kryesuese e Kuvendit

